

Kushtet e përgjithshme për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik fiks të MTS sh.p.k.

1. Dispozitat hyrëse

1. Këto Kushte të përgjithshme i paraqesin kushtet e menaxhimit për MTS sh.p.k, Mitrovicë e Kosovës, rr. Oslobogjenja numër 1, (në tekstin e mëtejshëm: Mts) për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik fiks të komunikimit (në tekstin e mëtejshëm: Shërbimet fikse të Mts-së).

2. Në vështrim të Kushteve të përgjithshme për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik fiks të Mts-së (në tekstin e mëtejshëm: Kushtet e përgjithshme), Shërbimet fikse të Mts-së, ndër të tjera, e përfshijnë: lidhjen në rrjetin publik të komunikimit të MTS-së, qasjen në rrjetin publik të komunikimit të MTS-së, shërbimet publike të telefonisë në disponim në rrjetin fiks, shërbimet me tarifë të veçantë, shërbimet e përdorimit të Internetit si edhe shërbimet e tjera të transmetimit të të folurit ose zërit, të dhënave, dokumenteve dhe fotografive, por edhe shërbimet publike të cilat ofrohen sipas bazës së Kushteve të përgjithshme. Kushtet e përgjithshme, karakteristikat e hollësishme teknike të rrjetit të Mts-së dhe kushtet e dhënies së shërbimeve të caktuara, gjenden në faqen zyrtare në internet të Mts-së (www.mtsdoo.com). Shërbimet e përfshira me Kushtet e përgjithshme u ofrohen shfrytëzuesve sipas çmimeve të përkufizuara me Listën e çmimeve të MTS-së (në tekstin e mëtejshëm: Lista e çmimeve) që është në përdorim në faqen zyrtare të internetit www.mtsdoo.com. Në të gjitha vendet e shitjes së MTS-së dhe të distributorëve të autorizuar.

3. Kushtet e përgjithshme nuk kanë të bëjnë me shërbimet e bartjes së të folurit përmes telefonit publik të MTS-së, ndaj shërbimeve të bartjes së të folurit me ndërmjetësimin e operatorit, shërbimit të dhënies së përmbajtjes programore përmes protokollit të internetit, shitjes së pajisjes terminale, si edhe ndaj shërbimeve të tjera të cilat në tekstin e mëtejshëm janë përjashtuar shprehimisht dhe/ose përdorimi i tyre është rregulluar me kushtet e veçanta të MTS-së.

4. Dhënia e secilit nga shërbimet me të cilin kanë të bëjnë Kushtet e përgjithshme, rregullohet përveç Kushteve të përgjithshme edhe me kontratë parapaguese (në tekstin e mëtejshëm: „Kontrata“). Me nënshkrimin e Kontratës, shfrytëzuesi e pranon aplikimin e Kushteve të përgjithshme. Kushtet e përgjithshme aplikohen në raportet midis MTS-së dhe parapaguesit/shfrytëzuesit gjatë vlefshmërisë së Kontratës dhe e përbëjnë pjesën përbërëse të Kontratës. Shmangiet nga Kushtet e përgjithshme janë të mundshme vetëm nëse janë përcaktuar me Kontratën e lidhur në formën me shkrim të cilën në emër të Mts-së e ka nënshkruar personi i autorizuar.

5. Mts ka të drejtë që në pajtim me ndryshimet e dispozitave të vlefshme, kushteve të dhënies së shërbimeve dhe politikës së vet menaxhuese, të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e Kushteve të përgjithshme dhe të Listës së çmimeve, për çfarë i informon në mënyrë të duhur parapaguesit/shfrytëzuesit 30 ditë më herët.

6. Ndaj të gjitha marrëdhënieve midis Mts-së dhe parapaguesit/shfrytëzuesit të cilat nuk janë rregulluar me këto Kushte të përgjithshme aplikohen dispozitat e ligjeve në fuqi dhe të dispozitave nënligjore.

2. Nocionet dhe përkufizimet

Në Kushtet e përgjithshme shprehjet në tekstin e mëtejshëm: i kanë këto kuptime:

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – (në tekstin e mëtejshëm Autoriteti) është organi rregullator, i cili e zbaton dhe e mbikëqyr kornizën rregullatore të përcaktuar me ligjin për komunikimet elektronike;

Identifikimi i linjës thirrëse ardhëse – funksioni që ia mundëson personit të thirrur ta identifikojë pikën terminale të rrjetit nga e cila bëhet thirrja, në bazë të numrit ose kodit që i është caktuar kësaj pike terminale të rrjetit

Ndërmarrës – çdo person fizik dhe/ose juridik ose grup personash të bashkuar në bazë të kontrollit ose varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike

Numri – një sërë shifrash i përcaktuar në planin e numerimit, eri ose adresa e cila përdoret adresim në rrjetin dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;

Operator – ndërmarrës, që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose mjete përkatëse:

Pajisjet terminale – pajisjet ose komponenta e saj relevante, e cila mund të pranojë dhe/ose të dërgojë informacion dhe është e projektuar që të lidhet në çfarëdo mënyre dhe për çdo rrjet publik të komunikimit;

Parapagues – cilido person fizik ose person juridik që ka lidhur një kontratë me një ndërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për shfrytëzimin e shërbimeve të ofruara;

Listë e çmimeve – lista e të gjitha shërbimeve të rrjetit fiks të Mts-së me çmimet përkatëse, e cila e përfshin përshkrimin dhe specifikimin e shërbimeve, e që mund të gjendet në të gjitha vendet e shitjes dhe në faqen zyrtare në Internet të Mts-së;

Postë elektronike – çdo mesazh në formë të tekstit, akustik apo në formë imazhi, i dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen terminale të marrësit derisa ai e merr;

Qasje – dhënia në përdorim e mjeteve dhe/ose shërbimeve një ndërmarrësi tjetër, nën kushte të përcaktuara, qoftë në baza ekskluzive ose joekskluzive, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë këtu edhe dhënien e shërbimeve të shoqërisë së informacionit ose shërbimeve të transmetimit të përmbajtjes.

Rrjet i komunikimeve elektronike – sistemi i transmetimit dhe, atje ku është aplikuar, pajisjet e komutimit dhe orientimit edhe burimet e tjera, duke përfshirë elementet pasive të rrjetit, të cilat e mundësojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet mjeteve me tela, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë

rrjetin satelitor, (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave), sistemet energjetike me kablllove, në pjesën e cila përdoret për transmetimin e sinjalit, rrjetit i cili përdoret për transmetimin e përmbajtjeve radiotelevizive dhe të përmbajtjeve të televizionit me kablo, pa e marrë parasysh llojin e informacionit i cili transmetohet;

Rrjeti i komunikimit publik – rrjeti i komunikimit elektronik që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, të cilat e mundësojnë transferimin e të dhënave midis pikave terminale të rrjetit;

Rrjeti publik fiks – rrjeti në të cilin pikat terminale gjenden në vendndodhje fikse;

Shërbim me vlerë të shtuar – është, sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjes së privatësisë, çdo shërbim që kërkon përpunimin e të dhënave për trafikun ose të dhënave për vendndodhjen, jashtë diapazonit që është i nevojshëm për transmetimin e një komunikimi ose faturimi të tij;

Shërbimi universal – një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë shfrytëzuesit pa e marrë parasysh pozitën e tyre gjeografike, sipas çmimeve të përballueshme;

Shfrytëzues – çdo person fizik ose juridik që shfrytëzon ose kërkon të shfrytëzojë shërbime të komunikimit elektronik, që është në disponim të publikut;

Të dhënat për trafikun – ato të dhëna të cilat janë përpunuar për bartjen e komunikimit brenda rrjetit të komunikimit elektronik, ose faturimit të tij;

Të dhënat për vendndodhjen – ato të dhëna të përpunuara brenda rrjetit të komunikimit elektronik, që tregojnë pozicionin gjeografik të pajisjes terminale të një shfrytëzuesi të shërbimit të komunikimeve elektronike të pranishme për publikun;

Thirrje – lidhja e vendosur përmes një shërbimi të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, që mundëson komunikimin e dyanshëm me zë.

Person – cilindo person fizik, juridik apo publik, duke përfshirë këtu edhe korporata, partneritete, truste, organizata të painkuadruara, ofrues të shërbimeve, Qeverinë apo çfarëdo institucioni që ka të bëjë me të.

3. Paraqitja e kërkesës dhe lidhja e Kontratës

1. Mts do ta marrë në shqyrtim kërkesën për dhënien e shërbimeve (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesa) nëse shfrytëzuesi ofron si dëshmi të gjitha të dhënat, dokumentet e identifikimit, autorizimin dhe dokumentet e tjera me të cilat konfirmohet identiteti i shfrytëzuesit. Personi juridik ia dërgon dokumentet përkatëse për regjistrim në regjistër përkatës, si edhe të dhënat e tjera të domosdoshme për nënshkrimin e Kontratës. Për shfrytëzues privatë kërkesën mund ta bëjë personi i moshës madhore, kurse për personin e moshës së mitur kërkesën e bën prindi ose kujdestari. Shfrytëzuesi me paraqitjen e kërkesës për lidhjen e Kontratës e pranon/jep pëlqimin që Mts mund ta verifikojë aftësinë paguese të shfrytëzuesit dhe në këtë vështrim e bën këmbimin e të dhënave për kryejën paraprake të obligimeve nga ana e shfrytëzuesit.

2. Kërkesa e shfrytëzuesit do të shqyrtohet me kusht që shfrytëzuesi t'i ketë shlyer të gjitha borxhet e rregullta të cilave u ka skaduar afati i pagesës, si edhe që kundër shfrytëzuesit nuk zhvillohet procedurë gjyqësore për arkëtimin e kërkesave. Gjithashtu, kundër shfrytëzuesit nuk guxon të ketë filluar procedura likuiduese ose falimentuese.

3. Paraqitja e kërkesës MTS mund t'i bëhet edhe në mënyrë elektronike (on-line) ose përmes ndonjë mjeti tjetër të komunikimit në largësi të cilin Mts e bën publikisht të mundshëm. Me paraqitjen e Kërkesës në këtë mënyrë, shfrytëzuesi e jep pëlqimin për përdorimin e mjeteve të komunikimit në largësi me qëllim të lidhjes së Kontratës dhe e konfirmon se është njohur edhe që pranon që Kontrata midis Mts-së dhe parapaguesit konsiderohet e lidhur me aktivizimin e shërbimit sipas procedurës së theksuar. Në rast të lidhjes së Kontratës në largësi dhe Kontratës jashtë ambienteve të menaxhimit, MTS do ta njoftojë paraqitësin e kërkesës për të gjitha të dhënat e përcaktuara me dispozita të veçanta për mbrojtjen e konsumuesit dhe të njëjtit do t'i jepet një ekzemplar i Kontratës, përkatësisht vërtetimi për Kontratën e lidhur, sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar me dispozitat e veçanta për mbrojtjen e konsumuesit.

4. Pas pranimit, Mts e fillon zgjidhjen e Kërkesës në pajtim me mundësitë teknike. Përparësia për lidhjen e marrëdhënies kontraktuese fitohet sipas ditës dhe orës së paraqitjes së kërkesës, por që MTs e ruan të drejtën për dhënien e përparësive shfrytëzuesve me rëndësi të veçantë (organet shtetërore, shfrytëzuesit të cilët e paraqesin kërkesën për shërbime në vëllim më të madh dhe/ose gjatë periudhës së caktuar dhe të ngjashme).

5. Mts shfrytëzuesin për zgjidhjen e Kërkesës do ta njoftojë brenda afatit prej 15 ditësh përveç në rastet kur për zgjidhjen e Kërkesës nevojiten aktivitetet plotësuese ose përmbarimi i infrastrukturës. Shfrytëzuesi në këtë rast do të njoftohet për afatin plotësues për zgjidhjen e Kërkesës brenda të cilit do të njoftohet për zgjidhjen përfundimtare të Kërkesës.

6. Pasiqë e njofton shfrytëzuesin se e ka pranuar Kërkesën e tij e thërret që brenda afatit prej 15 ditësh ta lidhë Kontratën.

7. Në rast se nuk ekzistojnë mundësi teknike për realizimin e Kërkesës, Mts për këtë do ta njoftojë shfrytëzuesin derisa të skadojë afati për ofrimin e shërbimit, kurse një Kërkesë të tillë do ta ruajë në evidencë të vet derisa e njëjta të revokohet nga ana e shfrytëzuesit. Kur të krijohen mundësitë teknike për realizimin e një Kërkesë të tillë, MTS ka për detyrë që shfrytëzuesit t'ia ofrojë lidhjen e Kontratës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e krijimit të mundësive teknike për realizim.

8. Kontrata midis parapaguesit dhe MTS lidhet në formën me shkrim, me nënshkrimin nga ana e parapaguesit dhe përfaqësuesit të autorizuar të MTS-së. Përveç nëse me Kontratë nuk është caktuar ndryshe, Kontrata lidhet për kohë të pacaktuar. Parapaguesi në këtë rast ka të drejtë të anulojë Kontratën për çdo gjë ose vetëm për ndonjë nga shërbimet, në cilindoqoftë moment, por që mbetet i obliguar t'ia paguajë Mts-së kompensimet për krijimin e mundësive teknike, për vendosjen, si edhe për përdorimin e shërbimeve në periudhën nga pushimi i vlefshmërisë së Kontratës.

9. Midis Mts-së dhe Parapaguesit mund të kontraktohet dhënia e shërbimeve me një periudhë minimale të kohëzgjatjes së obligueshme të Kontratës përkatësisht me një periudhë minimale të vlefshmërisë së Kontratës, në të cilin rast vlejnë sidomos kushtet e përkufizuara, në pajtim me Listën e çmimeve dhe me Kontratën. Me kontraktimin e kohëzgjatjes së obliguar të Kontratës parapaguesi i fiton disa përshtatshmëri, të cilat mund të kenë të bëjnë si me kushtet e veçanta të përdorimit të shërbimeve ashtu edhe me mundësinë e blerjes së aparateve të domosdoshme për përdorimin e shërbimeve, dhe këtë në pajtim me Kontratën.

4. Aktivizimi i shërbimeve eksploatuese

Aktivizimi

1. Mts, në pajtim me Kërkesën e shfrytëzuesit, do ta mundësojë përdorimin e shërbimeve elektronike të komunikimit përmes përdorimit të teknologjive të realizuara në disponim. Shërbimet e rrjetit fiks vendosen jo më vonë se brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së Kërkesës, përveç në rastet e jashtëzakonshme teknike ose në rastet kur me shfrytëzuesin është harmonizuar ndonjë afat tjetër. Nëse për dhënien e këtyre shërbimeve është i domosdoshëm përmbartimi i infrastrukturës në disponim, afati për dhënien e shërbimeve zgjatet derisa të krijohen mundësitë teknike. Para dhënies së shërbimit, Mts i verifikon kushtet a ka mundësi shfrytëzuesi që t'ia ofrohet shërbimi. Nëse kushtet në anën e Shfrytëzuesit nuk janë plotësuar, me pëlqimin e Mts-së, afatet mund të zgjaten derisa Shfrytëzuesi nuk i plotëson kushtet, jo më gjatë se deri 15 ditë. Në rast të mosplotësimit të kushteve brenda afatit të theksuar për shkaqe të cilat gjenden në anën e shfrytëzuesit, Mts mundet njëanshëm ta anulojë Kontratën dhe të heqë dorë nga realizimi i kërkesës.

2. Aktivizim i shërbimeve konsiderohet lidhja e pajisjes terminale në rrjetin fiks të Mts-së në vendndodhjen e lidhjes së theksuar në Kërkesë, përkatësisht kur i mundësohet Parapaguesit që t'ia përdorë shërbimet fikse.

3. Përlllogaritja dhe arkëtimi i shërbimeve fillon me aktivizimin e shërbimit në pajtim me Kontratën dhe me Kushtet e përgjithshme, dhe këtë sipas Listës së çmimeve.

4. Parapaguesi me shpenzime të veta do t'ia mundësojë Mts-së hyrjen në objekt në vendndodhjen ku bëhet lidhja, si edhe përdorimin e pasurisë së paluajtshme të Parapaguesit pa kompensim në masën në të cilën kjo është e nevojshme për zbatimin e punimeve të ekzaminimit, instalimit, mbivendosjes, modernizimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit elektronik të komunikimit dhe/ose pajisjes terminale, përkatësisht dhënies së shërbimeve.

Pajisja terminale dhe qasja rrjetit

5. Për përdorimin e disa shërbimeve fikse të Mts-së Parapaguesi mund ta zgjedhë instalimin e pavarur të pajisjes terminale. Në këtë rast aktivizimi i shërbimit fillon ditën e rimarrjes së pajisjes terminale në vendndodhjen e lidhjes nga ana e Parapaguesit.

6. Parapaguesi obligohet se nuk do ta dëmtojë në asnjë mënyrë as nuk do ta ndryshojë pajisjen terminale e cila është në pronësi të Mts-së, që pajisjen e theksuar nuk do ta zhvendosë nga vendndodhja ku është bërë lidhja për të cilën është destinuar. Mirëmbajtjen dhe ndryshimin e pajisjes së instaluar terminale e cila është në pronësi të Mts-së, mund ta bëjnë vetëm personat e autorizuar nga ana e Mts-së, nëse nuk është theksuar ndryshe në Kontratë. Gjithashtu, Parapaguesi obligohet se do ta informojë Shërbimin e përdorimit të Mts-së për numrat e theksuar në pikën 14.3, për dëmtimin ose humbjen e pajisjes terminale. Pas anulimit të Kontratës, Parapaguesi ka për detyrë që Mts-së t'ia kthejë pajisjen terminale në pronësi të Mts-së në gjendje të rregullt. Në të kundërtën, Parapaguesi ka për detyrë që t'ia kompensojë dëmin Mts-së në pajtim me Listën e çmimeve.

7. Shfrytëzuesi mban përgjegjësi për përdorimin e shërbimeve të mundësuarat përmes qasjes në rrjetin elektronik të komunikimit, si edhe për dëmin eventual të bërë personit të tretë që është krijuar përmes qasjes në rrjetin elektrik të komunikimit.

Pajisja e Parapaguesit dhe instalimi në shtëpi

8. Parapaguesi ka për detyrë që në vendndodhjen në të cilën bëhet lidhja ta sigurojë instalimin shtëpiak në pajtim me dispozitat e vlefshme dhe me shpenzime të veta ta sigurojë pajisjen përkatëse terminale përkatësisht të njëjtën ta përshtatë për shfrytëzim të shërbimeve fikse të Mts-së, mbushjen e nevojshme për instalimin e saj, punën dhe mirëmbajtjen.

9. Nëse Parapaguesi me shpenzime të veta ndërton dhe mirëmban instalimin e vet të brendshëm përmes të cilit lidhet në Rrjet, ka për detyrë që t'i respektojë kushtet teknike të përcaktuara me dispozitat e vlefshme. Parapaguesi do ta lidhë në Rrjet vetëm instalimin dhe pajisjen të cilën e lejon Mts, e që janë në pajtim me dispozitat teknike. Parapaguesi mban përgjegjësi për rregullsinë dhe përdorimin e instalimeve dhe pajisjeve të tilla. Parapaguesi do t'u përmbahet udhëzimeve të Mts-s kur e lidh instalimin dhe pajisjen në Rrjet dhe me rastin e përdorimit të shërbimeve. Në rast të dyshimit në rregullsi, shfrytëzimi ligjor dhe i kontraktuar, Mts ka të drejtë që pa paralajmërime të mëparshme ta bëjë kontrollin e instalimit dhe të pajisjes (të harduerit dhe të softuerit) të Parapaguesit. Në rast të mosrespektimit të këtyre dispozitave të Kushteve të përgjithshme, Mts mund ta bëjë ndërprerjen e përkohshme dhe të përhershme të dhënies së shërbimeve në pajtim me pikën 11.

Dhënia e shërbimeve plotësuese

10. Me kërkesën e shfrytëzuesit, Mts bashkë me shërbimin themelor do të ofrojë edhe shërbime plotësuese nga oferta e vet, nëse për këtë janë plotësuar kushtet teknike. Disa shërbime plotësuese mund të përdoren vetëm me ndihmën e pajisjes së veçantë terminale e cila i mbështet shërbimet e tilla. Përveç nëse me Kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, Kontrata themelore aplikohet edhe për shërbimet plotësuese. Shërbimet plotësuese fakturohen në pajtim me Listën e çmimeve.

Shpërngulja e shërbimeve

11. Parapaguesi mund të kërkojë „shpërnguljen“ e shërbimeve, nga një vendndodhje (adresë) në vendndodhjen tjetër (adresën), me paraqitjen e kërkesave përkatëse.

12. Brenda afatit prej 15 ditësh pas marrjes së kërkesës së Parapaguesit për shpërngulje, Mts do t'ia dërgojë Parapaguesit informatën se pranon që kërkesa për shpërngulje, nëse ekzistojnë kushtet teknike në vendndodhje të re ose për refuzimin e kërkesës, me të cilin rast është e pranueshme secila mënyrë e njoftimit që mund të dëshmohet (psh, thirrja me telefon, posta elektronike, posta e rekomanduar, automati folës, IVR). Në rast të pranimit të kërkesës për shpërngulje, brenda afatit jo më shumë se 30 nga dita e njoftimit të Parapaguesit, Mts do ta bëjë shpërnguljen.

13. Për realizimin e shpërnguljes, Mts ka të drejtë në pajtim me Listën e çmimeve ta faturojë shumën e kompensimit të njëhershëm për shpërnguljen e shërbimit, të cilin Parapaguesi e paguan përmes llogarisë së lëshuar nga ana e Mts-së.

5. Të dhënat për Parapaguesin dhe trafikun e realizuar

1. Mts i grumbullon dhe i përpunon të dhënat personale të Parapaguesit, për çdo gjë sipas Ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Mts e garanton sekretin e të dhënave personale të shfrytëzuesit në kufijtë e dispozitave të vlefshme. Me të dhënat e theksuara Mts mund të veprojë me qëllim të realizimit të Kontratës, kryerjes së obligimeve të veta të bazuara në ligj, arkëtimit të kërkesave, dhe për qëllime të tjera me pëlqimin e Parapaguesit.

3. Të dhënat për trafikun janë të lidhura me Parapaguesin konkret, përveç me qëllim të kryerjes së obligimeve të përcaktuara me dispozitat e vlefshme, përpunohen dhe ruhen në masën në të cilën kjo është e domosdoshme për përlllogaritjen e llogarisë dhe për periudhen derisa të skadojë afati i përcaktuar me ligj për paraqitjen e kundërshtimit nga ana e Parapaguesit dhe derisa të skadojë afati për arkëtimin e kërkesave.

4. Parapaguesi me lidhjen e Kontratës e pranon se, në rast se përmes rrjetit të Mts-së i përdor shërbimet me vlerën e shtuar të personave të tretë – të operatorit të shërbimeve të theksuara, të dhënat nga pikat 2 dhe 3 të këtij paragrafi mund t'u dërgohen operatorëve të shërbimeve me vlerë të shtuar shërbimet e të cilëve i ka përdorur, dhe këtë nga pika 2, me qëllim të arkëtimit të kërkesave nga ana e operatorëve të theksuar, kurse të dhënat nga pika 3, me qëllim të arkëtimit të kërkesave dhe zgjidhjes së kundërshtimit nga ana e këtyre operatorëve.

Numërori telefonik

6. Parapaguesi me lidhjen e Kontratës e pranon se Mts do t'i përmbajë të dhënat e Parapaguesit në numërorin e vet publik telefonik që e ka (elektronik dhe të shtypur). Mts nuk ka për detyrë që të verifikojë saktësinë e të dhënave të cilat i ka dhënë Parapaguesi në numëror telefonik. Parapaguesi ka të drejtë që Mts-së, pa qenë i detyruar që të paguajë kompensime, t'ia suprimojë pëlqimin e dhënë më parë përkatësisht të kërkojë shlyerjen e të dhënave të tij nga numërori telefonik.

Ndryshimi i të dhënave

7. Parapaguesi do ta njoftojë mts-në për secilin ndryshim të të dhënave të veta të cilat janë të nevojshme për aplikimin e Kontratës menjëherë pasi që të vijë deri te ndryshimi. Nëse Parapaguesi këtë nuk e bën, do të përgjigjet për secilin dëm i cili i krijohet Mts-së për shkak të kësaj ose personave të tretë. Nëse nga i njëjti shkak llogaritë, vërejtjet për shkak të mospagimit dhe dokumentet e tjera të Mts-së nuk mund t'i dërgohen, do të konsiderohet se në bazë të dhënave ekzistuese dërgimi është bërë në mënyrë të duhur.

8. Ndryshim i të dhënave të Parapaguesit konsiderohet edhe ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit të personit fizik, ose ndryshimi i emrit menaxhues i shoqërisë ekonomike, si edhe rasti i ndryshimeve statusore të shoqërisë ekonomike të bëra në pajtim me dispozitat e vlefshme.

Identifikimi i numrit

9. Kur vendoset linja thirrëse numri i thirrësit, kur kjo teknikisht është e mundur, gjithnjë bartet përmes Rrjetit, me përjashtim nëse thirrësit me kërkesë të tij i është parandaluar identifikimi i numrit thirrës. Identifikimi i numrit të thirrur patjetër tregohet në rastet e thirrjes së shërbimit për ndërhyrje urgjente, ose shërbimit të Mts-së për paraqitjen e pengesave, reklamimeve, paraqitjes së kërkesës për shërbim dhe kontrollit të rrjetit.

6. Kompensimet, çmimet dhe llogaria

1. Kompensimin për shërbim sipas rregullit e përbëjnë: shuma e njëhershme për themelimin marrëdhënies parapaguese (për dhënien e shërbimit dhe për krijimin e mundësive teknike) dhe kompensimi mujor për qasje në Rrjet dhe/ose shërbimit, si edhe kompensimi për trafikun e realizuar, kompensimi për përdorimin e pajisjes terminale dhe kompensimit për shërbimet plotësuese. Shërbimet dhe sigurimi i kushteve për dhënien e shërbimeve, siç është përmbarimi i infrastrukturës së nevojshme nëse bëhet, paguhen sipas Listës së vlefshme të çmimeve të Mts-së. Thirrjet në drejtim të shërbimeve për ndërhyrje urgjente mundësohen pa kompensim.

4. Kompensimi mujor për dhënien e shërbimeve fikse, fakturohet për muajin në të cilin janë përdorur shërbimet dhe jepet si zë/pjesë e veçantë në llogari.

5. Mts e lëshon llogarinë më datën një të muajit, për muajin paraprak dhe ia dërgon në adresë Parapaguesit përveç nëse Parapaguesi e ka kërkuar në ndonjë mënyrë tjetër, dhe që mund të gjendet në formën elektronike të të gjithë parapaguesve përmes faqes zyrtare të Mts-së e theksuar në nenin 1, të Kushteve të përgjithshme, të emailit,

qendrës për kontakte, zyre ose vende të autorizuar të shitjes së Mts-së. Nëse Parapaguesit nuk i dërgohet llogaria në emër të shërbimeve të ofruara, Parapaguesi deri në ditën e skadimit të afatit për pagimin e llogarisë do ta njoftojë për këtë Mts-në, duke shkuar në zyre, me shkrim, duke dërguar e-mail ose duke e thirrur qendrën e thirrjeve në numrin e shënuar në pikën 14.3 që llogaria përkatësisht informata për shumën e llogarisë t'i dërgohet. Mts e ruan të drejtën që ta ndryshojë kohën e lëshimit të llogarisë, për çfarë me kohë do ta njoftojë Parapaguesin në mënyrë adekuate.

6. Me kërkesën e Parapaguesit, do t'i dërgohet specifikimi i detajuar i të gjitha shërbimeve të cilat arkëtohen me përlllogaritje të veçantë të ngarkimit për secilin shërbim individualisht. Kjo Parapaguesit do t'i mundësohet jo më pak se në periudhën brenda së cilës mund të paraqesë kundërshtim për shumën e llogarisë.

Ndryshimi i çmimit dhe i kushteve të dhënies së shërbimeve

7. Mts ka të drejtë t'i ndryshojë kushtet e veta të dhënies së shërbimeve, Listën e çmimeve dhe Kushtet e përgjithshme.

8. Mts ndryshimet e theksuara i publikon në faqen e vet zyrtare në internet www.mtsdoo.com, në zyrat dhe në vendet e tjera të shitjes së Mts-së, në pajtim me dispozitat në fuqi.

9. Në rast të ndryshimit të çmimeve të kushteve të kontraktuara të dhënies së shërbimeve dhe Kushteve të përgjithshme vetëm në favor të Parapaguesit, të njëjtat mund të aplikohen ndaj Parapaguesve në ditën e publikimit të këtyre ndryshimeve.

10. Në rast të ndryshimit të çmimeve të kushteve të kontraktuara të dhënies së shërbimeve dhe Kushteve të përgjithshme të cilat sjellin deri te shtimi i kompensimeve ose kushteve të pavolitshme për Parapagues, Parapaguesi do të njoftohet në mënyrë adekuate, jo më vonë se 30 ditë para aplikimit të ndryshimeve të theksuara.

11. Ndryshimet dhe plotësimet e Kushteve të përgjithshme të cilat janë harmonizim me dispozitat e vlefshme ligjore nuk konsiderohen ndryshim i kushteve nën të cilat është lidhur Kontrata në dëm të Parapaguesit.

7. Arkëtimi i kërkesave

1. Parapaguesi ka për detyrë që të shlyejë tërë shumën e përlllogaritur të llogarisë deri në ditën e maturimit të llogarisë së theksuar Mts-së.

2. Shfrytëzuesve u është mundësuar ta paguajnë llogarinë të të gjitha institucionet e regjistruara për transferim të pagesave. Parapaguesi mund ta paguajë llogarinë edhe me urdhër të përhershëm te bankat të cilat ofrojnë shërbim për transaksionin e theksuar të pagesave. Kompensimin për transaksioni e kryer të pagesave e mban Shfrytëzuesi në pajtim me Listën e çmimeve dhe me kushtet e dhëniesit të shërbimeve të transferimit të pagesave.

3. Mts nuk mban përgjegjësi nëse pagesa nuk ka mundur të evidentohet për shkak se Parapaguesi ka dhënë të dhëna të pasakta dhe/ose jo të plota, që nuk e ka shkruar siç duhet në formularin për pagesë numrin e llogarisë dhe/ose të dhënat e

domosdoshme për evidentimin e rregullt të pagesës, ose që pagesa nuk është evidentuar për shkak të gabimit të organizatës për kryerjen e transferimit të pagesave, si edhe në rastin e fillimit të masave të ndërprerjes së dhënies së shërbimeve dhe padisë në gjykatë për shkak të moskryerjes së obligimit të pagesës. Një pagesë e tillë do të evidentohet vetëm atëherë kur mjetet të paguhen në llogari të Mts-së ose nëse Parapaguesi ofron dëshmi se e ka bërë pagesën. Në rast se janë paguar më shumë të holla se sa shuma në llogari, Mts do ta zvogëlojë shumën për pagimin e llogarisë në periudhën e ardhshme, ose do ta kthejë tepricën e shumës së paguar me kërkesën e Parapaguesit. Parapaguesi i mban të gjitha shpenzimet të cilat mund të krijohen lidhur me pagimin e llogarisë, si edhe të gjitha shpenzimet e kthimit të të hollave të paguara tepricë nëse kjo është bërë për shkak të gabimit të Mts-së.

4.Parapaguesi ka për detyrë që ta paguajë kamatën ligjore për vonesë për shkak të tejkalimit të afatit të pagimit të llogarisë, e cila llogaritet deri në ditën e pagimit të mjeteve në xhirollogari të Mts-së. Pas skadimit të afatit për pagimin e llogarisë, Mts ia dërgon vërejtjen Parapaguesit. Nëse Parapaguesi nuk e shlyen obligimin e pagesës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e maturimit të obligimit të pagesës sipas llogarisë së dërguar nga ana e Mts-së (me kusht nëse ka kaluar edhe afati prej jo më pak se 8 ditësh nga dërgimi i vërejtjes për shkak të moskryerjes së pagesës), Mts ka të drejtë që Parapaguesit përkohësisht t'ia ndërprejë dhënien e një ose të gjitha shërbimeve të cilat i ofron sipas Kontratës sipas së cilës Parapaguesi nuk i kryen obligimet e veta kontraktuese, por që shërbimet e thirrjes ndërpriten pjesërisht, e jo në tërësi, domethënë kufizohen, kështu që edhe më tutje mundësohen të gjitha shërbimet e linjës së thirrjeve ardhëse që vijnë për të cilat me Listë të çmimeve të Mts-së nuk është përcaktuar obligimi i pagesës, si edhe thirrjes së shërbimit për ndërhyrje urgjente.

5.Në rast se Parapaguesi nuk e shlyen obligimin e pagesës derisa të skadojë afati prej 45 ditësh i kohëzgjatjes së kufizimit të shërbimeve të thirrjeve sipas mënyrës së theksuar (60 ditë nga dita e maturimit të obligimit të pagimit), Mts ka të drejtë që Parapaguesit t'ia ndalë edhe shërbimet e thirrjes në tërësi. Shërbimet do t'i kthehen përsëri Parapaguesit në ditën e shlyerjes së obligimit, e jo më vonë se 2 ditë pune pas shlyerjes së borxhit.

6. Nëse Parapaguesi nuk e paguan llogarinë as pas 75 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë për pagesë, me të cilin rast ka kaluar afati prej jo më pak se 30 ditësh prej së paku një vërejtjeje dhe jo më pak se 8 ditë nga vërejtja para ndërprerjes së përhershme, Kontrata do të ndërpritet dhe Parapaguesit do t'i ndalet dhënia e shërbimit ose shërbimeve përgjithmonë, pajisja terminale do të shkyçet nga Rrjeti, kurse borxhi do t'i dërgohet gjykatës që ta bëjë arkëtimin e detyrueshëm.

7. Mts është i autorizuar që t'ia kalojë të drejtat të cilat i ka ndaj Parapaguesit të shërbimeve personave të tretë, bankave dhe agjencive për arkëtim të kërkesave, sipas mënyrës dhe në pajtim me dispozitat në fuqi, me të cilin rast Parapaguesi i shërbimeve nuk mban përgjegjësi për shpenzimet e kalimit të të drejtave as kurrfarë shpenzimesh të tjera që do të mund të krijoheshin nga kalimi i të drejtave të kërkesave.

Mjetet e sigurimit të pagesës

8. Nëse për shkak të aftësisë paguese të shfrytëzuesit, që ai t'i kryejë obligimet e pagimit në periudhën e mëparshme, përdorimit mesatar të shërbimit, shumës së borxhit të përgjithshëm, Mts objektivisht vlerëson se Parapaguesi nuk do t'u përmbahet obligimeve të kontraktuara të pagesës, ose që kërkesat vështirë do të arkëtohen, Mts mund të kërkojë nga Parapaguesi që të deponojë një shumë të caktuar të mjeteve që të sigurojë pagesën e cila është e pranueshme për Mts. Nëse Parapaguesi nuk e bën këtë, Mts ka të drejtë që të ndërmarrë masa të ndërprerjes së përkohshme të dhënies së shërbimeve, të theksuara në pikën 11. Mts ka të drejtë të shlyejë tërë kërkesat ndaj Parapaguesit nga mjetet e deponuara me të cilat e ka siguruar pagesën.

8. Obligimet dhe përgjegjësia e MTS-së

Dispozitat e përgjithshme

1. Nëse Mts nuk i respekton afatet e përcaktuara të vendosjes së shërbimeve, riparimit të prishjes dhe afatet e tjera të dakorduara, nëse gabimisht e kufizon ose e ndërpre dhënien e shërbimeve, Parapaguesi ka të drejtë për kompensim në pajtim me rregullat për kompensimin e dëmit Parapaguesit nga pika 15 e Kushteve të përgjithshme.

2. Derisa është në pronë të shfrytëzuesit, Mts do t'i ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e pronës së shfrytëzuesit dhe masat e domosdoshme të sigurisë, me të cilin rast shfrytëzuesi ka për detyrë që të përmbahet nga të gjitha veprimet të cilat do të mund t'i dëmtonin objektet, instalimin dhe pajisjen e Mts-së. Shfrytëzuesi ka për detyrë ta respektojë ndalimin dhe kushtet e përcaktuara sipas dispozitave të vlefshme në pikëpamje të punimeve në afërsi të rrjetit elektronik të komunikimit dhe të mjeteve përkatëse përkatësisht objekteve të tjera.

Cilësia e shërbimeve, mirëmbajtja e rrjetit dhe pengesat

3. Mts obligohet se Parapaguesit do t'ia ofrojë shërbimet e kontraktuara në pajtim me parametrat e përkufizuar të cilësisë të cilat i përcakton Autoriteti.

4. Mts ka për detyrë që t'i mirëmbajë të gjitha burimet e rrjetit elektronik të komunikimit sipas mënyrave të cilat e mundësojnë përdorimin e vazhdueshëm të shërbimeve kontraktuese.

5. Mts mban përgjegjësi për funksionimin e pajisjes terminale e cila i është ndarë Parapaguesit, përveç nëse prishja e pajisjes nuk bëhet për shkak të fajit të Parapaguesit.

6. Mts e siguron punën e rregullt dhe të papenguar të rrjetit publik të komunikimit. Në pajtim me këtë që u theksua Mts rregullisht do ta mirëmbajë pajisjen, do ta përparojë dhe do të punojë në modernizimin e infrastrukturës së vet, si edhe do ta kontrollojë funksionimin dhe cilësinë e shërbimeve në pajtim me standradet dhe dispozitat teknike.

7. Paraqitja e mosfunksionimit të shërbimeve përkatësisht pengesat bëhet duke e thirrur Qendrën për kontakte, përmes web portalit, përmes postës elektronike ose në formën me shkrim në adresë nga llogaria.

8. Nëse shërbimi nuk ka qenë në disponim më gjatë se 48 orë për shkaqe të cilat gjenden në anën e Mts-së, kompensimi mujor për shërbim, sipas kërkesës së Parapaguesit llogaritet në përpjesëtim me kohën sa e ka në disponim, përveç nëse cilësia e dhënies së shërbimit nuk është rregulluar ndryshe me Kontratë.

Fuqia madhore

9. Mts nuk mban përgjegjësi nëse për shkak të fuqisë madhore të dhënies së shërbimeve përkohësisht është ndërprerë ose është kufizuar shërbimi. Fuqi madhore do të konsiderohen ngjarjet natyrore me intensitet të veçantë (vërshimet, tërmeti, zjarri etj.), lufta, terrorizmi, grevat, humbja e autorizimeve dhe/ose lejes për dhënien e shërbimeve në rrjetin elektronik të komunikimit, reduktimit të papërcaktuar të organeve shtetërore, hyrjeve të befashme dhe parregullsive të mbushjes të shkaktuara nga ana e personave të tretë, sulmet e viruseve kompjuterike dhe ngjarjet tjera të ngjashme.

9. Rregullat e sjelljes në rrjet

1. Me qëllim të mbrojtjes nga keqpërdroimi dhe mashtrimet në rrjetin publik të komunikimit, Mts i zbaton masat për mbrojtjen e sigurisë së rrjetit publik fiks dhe shërbimeve të shfrytëzuesit.

2. Shërbimet e Mts duhet të përdoren vetëm në mënyrë ligjore dhe në pajtim me qëllimin e përcaktuar me Kontratë dhe me Kushte të përgjithshme.

3. Me rastin e përdorimit të shërbimeve të Mts ndalohe:

i) dërgimi, marrja dhe/ose magazinimi i çfarëdo të dhënash të cilat:

- e zbulojnë sekretin e menaxhimit, ose të dhënat personale të personit tjetër,

- mund t'i bëjnë dëm Mts-së ose cilitdo personi tjetër

- diskriminojnë ose keqpërdorin,

- janë ofenduese në krahasim me cilindo individ ose grup,

- janë shpifëse ose frikësuese ndaj cilitdo personi,

- në kundërshtim me licencën për mbrojtjen e cilitdo softueri;

ii) përdorimi i shërbimeve në cilëndo mënyrë që mund të rrezikojë rrjetin elektronik të komunikimit dhe dhënien e shërbimeve në të;

iii) publikimin ose bartjen e materialit promovues ose reklamues që përmban informacione të rreme, thënie ose pohime të cilat sjellin në lajthim;

iv) dërgimin e materialit reklamues ose promovues pa pëlqimin e tyre ose me kërkesën e marrësit, duke përfshirë edhe dërgimin e postës jo të kërkuar elektronike, përkatësisht mesazheve jo të kërkuara elektronike (spam);

v) publikimi, barja ose dërgimi i përmbajtjeve të mbrojtura me të drejtën e pronësisë intelektuale pa pëlqimin e pronarit të përmbajtjes, përkatësisht të atij që ka të drejtë për shpërndarjen e tyre;

vi) publikimin, dërgimin ose bartjen e përmbajtjeve që ofrojnë shërbime ose produkte në formën e letrave të njëpasnjëshme;

vii) mbikëqyrjen ose parapritjen e komunikimit ose mesazheve të personave të tretë;

viii) shqetësimin e shfrytëzuesve të tjerë në rrjetin e Mts-së ose rrjetin e ndonjë operatori tjetër me të cilin rrjeti i Mts-së është i lidhur drejtpërdrejtë ose tërthorazi në dërgimin e sasisë së madhe të mesazheve të padëshirueshme ose jo të kërkuara elektronike ndonjë personi (*mail/message bombing*);

x) përfaqësimi i rremë, përdorimi i emrit të huaj të përdorimit, lejkalimi dhe çelësi për shifrim, përkatësisht trukimi i mbishkrimit të mesazhit;

xi) qasja jo e autorizuar në llogari të shfrytëzuesit të huaj, burimeve të huaja (të dhënave, aparateve terminale dhe aparateve të tjera të komunikimit, kompjuterëve, masave të sigurisë) dhe përdorimi dhe mbikëqyrja e tyre jo e autorizuar;

xii) depërtimi i emrit të huaj të përdoruesit, fjalëkalimit, çelësit për shifrim dhe të ngjashme;

xiii) dërgimi dhe futja e virusit, programeve „të kamufluara“/trojan Horse/ dhe kodit tjetër malicioz në pajisje të huaj, përkatësisht në softuer;

xiv) dhënia në përdorim e shërbimeve të Mts-së personave jo të autorizuar, për shembull dhënien ose dhënien në përdorim personave jo të autorizuar me emër të ndarë të përdorimit, fjalëkalimit, çelësit për shifrim dhe në përgjithësi cilitdo elementi në bazë të të cilit personi jo i autorizuar mundet në vend të shfrytëzuesit të vendosë lidhjen, ta kryejë komunikimin, ta dërgojë ose lexojë mesazhin;

xv) zbatimi i veprimeve të cilat shfrytëzuesve të tjerë ua pamundësojnë përdorimin e rregullt të shërbimeve (*distributed denial of service*);

xvi) përdorimi i shërbimeve për bypass të trafikut ndërkombëtar.

Mts e ruan të drejtën që në rast të dyshimit, paraqitjes, kundërshtimit ose ankeës ta bëjë verifikimin e cilitdo burimi përkatësisht fajleve në të cilat janë shënuar të dhënat e kërkuara, dhe këtë në pajtim me dispozitat e vlefshme.

4. Mts ka të drejtë t'i regjistrojë thirrjet e dërguara në qendrën për kontakte të Mts-së, për çfarë personi do të njoftohet para vendosjes së lidhjes me të punësuarit në Mts në qendrën për kontakte.

Përdorimi i shërbimeve dhe i masave për parandalimin e keqpërdorimeve

5. Parapaguesi mban përgjegjësi për përdorimin e lidhjes së vet në rrjetin elektronik të komunikimit, për instalim në shtëpi dhe përdorimin e secilit prej shërbimeve në pajtim me ligjin dhe me Kontratën, me të cilin rast për çdo gjë do t'u përmbahet Kushteve të përgjithshme. Në të kundërtën, Mts ka të drejtë t'i ndërmarrë masat në pajtim me Rregullat për dhënien e përkohshme ose të përhershme të shërbimeve.

6. Parapaguesi mban përgjegjësi për përmbajtjen e mesazhit të cilin e bart përmes Rrjetit, ose përmbajtjen e të cilit mund ta shohin personat e tretë. Mts nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e mesazheve të theksuara, për mesazhe të cilat i pranon Parapaguesi, as për përmbajtjen e çfarëdo mesazheve të cilat i përhap personi i tretë ose i bën transparente përmes rrjetit. Në rast të përdorimit të shërbimeve për trajtim jo të autorizuar me informata ose burime të huaja përkatësisht për kryerjen e çfarëdo veprimesh ilegale, duke përfshirë edhe shkeljen e të drejtave të pronës intelektuale, ose për mundësimin e çfarëdo nga kjo që u theksua personit të tretë, Parapaguesi do të jetë i obliguar që ta rimarrë tërë përgjegjësinë, dhe që Mts-së t'ia kompensojë tërë dëmin e pësuar për shkak të një veprimi të tillë dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe shpenzimet e zhvillimit të kontestit.

Mungesa e përgjegjësisë për informata dhe blerjen përmes Rrjetit

7. Nëse shërbimet e Mts-së përdoren për blerjen e mallit ose shërbimit nga personat e tretë ose për nevoja të përdorimit të shërbimeve të personit të tretë përmes Rrjetit të Mts-së, përgjegjësinë për shërbime ose mallin e blerë ose të porositur sipas mënyrës së theksuar e mban personi i tretë i cili është dhënë i shërbimeve përkatësisht shitës i mallit.

10. Kundërshtimet e Parapaguesit

1. Parapaguesi mund të paraqesë kundërshtim në përlogari ose llogari për shërbime të ofruara të komunikimit, për cilësi përkatësisht funksionimin e shërbimeve si edhe kundërshtime të tjera të cilat mund të kenë të bëjnë me statusin e shërbimit, marrëdhënies kontraktuese ose përkrahjen e shfrytëzuesit.

2. Shfrytëzuesit privatë mund të bëjnë kundërshtim me gojë ose me shkrim. Shfrytëzuesit menaxhues kundërshtimet, përveç kundërshtimit për funksionim, i paraqesin me shkrim.

3. Kundërshtimet mund të dërgohen në adresën e theksuar në pikën 14, si adresë për komunikim me shfrytëzuesin: përmes Qendrës për kontakte, emailit, faqes zyrtare në internet, në zyra të Mts-së përkatësisht në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me dispozitat e vlefshme. Gjithashtu, kundërshtimet me shkrim mund të dërgohen në adresë të kompanisë:

MTS SH.P.K

Oslobogjenja 1

Mitrovica e Kosovës

Parapaguesit me kohë do të njoftohen për secilin ndryshim të adresës në të cilën mund të dërgohen kundërshtimet.

4. Parapaguesi ka të drejtë të paraqesë kundërshtim lidhur me cilësinë ose funksionimin e shërbimit brenda afatit prej 30 ditësh nga data e dhënies së shërbimit përkatësisht brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e maturimit për arkëtimin e llogarisë për shërbim kur bëhet fjalë për kundërshtim ndaj llogarisë ose shumës së llogarisë për shërbimin e dhënë. Pas skadimit të afateve të theksuara, konsiderohet se

Parapaguesi plotësisht është dakord me kushtet, mënyrën e realizimit dhe llogarinë e dhënë për shërbime të ofruara.

5. Parapaguesi i cili bën kundërshtim nga paragrafi 1 i këtij neni ndaj shumës me të cilën është i ngarkuar për shërbimin e dhënë, deri te zgjidhja e kundërshtimit e paguan pjesën jokontestuese të shumës së llogarisë për dhënien e shërbimit ose shumën mesatare me të cilën ka qenë i ngarkuar në periudhën prej jo më shumë se tre muajve para periudhës për të cilën ka të bëjë kundërshtimi. Në rast të mosshlyerjes së pjesës jokontestuese të shumës së llogarisë për shërbimin e dhënë ose shumës mesatare me të cilën shfrytëzuesi i fundit ka qenë i ngarkuar për periudhën prej jo më shumë se tre muaj para periudhës me të cilën ka të bëjë kundërshtimi, Mts ka të drejtë t'i zbatojë masat në pajtim me nenin 11 të Kushteve të përgjithshme.

6. Për shërbimet e operatorit të shërbimeve me vlerën e shtuar të cilët këto shërbime i ofrojnë përmes rrjetit të Mts-së kurse përgjigjen operatorët e shërbimeve me vlerën e shtuar dhe kundërshtimet për shumën e ngarkimit dhe për cilësinë e shërbimit me vlerën e shtuar u dërgohen operatorëve të theksuar për zgjidhje.

7. Afati për zgjidhjen e kundërshtimeve është 15 ditë (nëse dita e 15 bie të dielen ose në ndonjë ditë pushimi, afati shtyhet për ditën e parë të punës). Parapaguesit përgjigja do t'i dërgohet përmes kanalit të komunikimit të cilin e ka zgjedhur vetë.

8. Nëse Parapaguesi nuk është i kënaqur me zgjidhjen e kundërshtimit, mundet, përveç të drejtave të tjera të cilat i ka në pajtim me Ligjin, brenda afatit prej 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes nga Mts, përkatësisht nga skadimi i afatit për dërgimin e përgjigjes, t'i drejtohet Autoritetit për ndërmjetësim për zgjidhjen e kontestit jashtë gjykatës ose ta fillojë procedurën kontestimore para gjykatës kompetente.

11. Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve

1. Mts ka të drejtë që në rastet kur Parapaguesi nuk i respekton të drejtat dhe obligimet nga Kontrata, duke përfshirë edhe Kushtet e përgjithshme përkohësisht ta ndërprejë lidhjen e shfrytëzuesit nga Rrjeti i vet dhe/ose, në pajtim me dispozitat e vlefshme, përkohësisht t'ia ndalë dhënien e një ose më shumë ose të gjitha shërbimeve, me njoftimin parapark të Parapaguesit, përveç në rastin e dëmtimit fizik, material ose funksional të rrjetit, përkatësisht rrezikimit të sigurisë së Rrjetit, keqpërdorimeve të rënda ose të përsëritura, kur Parapaguesi mund ta ndërprejë edhe pa njoftim të mëparshëm.

2. Mts nuk ka për detyrë ta kompensojë dëmin eventual i krijuar për shkak të ndërprerjes së përkohshme të dhënies së shërbimeve, nëse në nenin 15 të Kushteve të përgjithshme nuk është përcaktuar shprehimisht më ndryshe.

3. Ndërprerja e përkohshme e dhënies së një, disa ose të gjitha shërbimeve të Mts-së mund të kryhet:

Në përgjithësi:

i) nëse konstatohet se Parapaguesi nuk po i respekton Kushtet e përgjithshme;

ii) nëse konstatohet se Parapaguesi ka dhënë të dhëna të rreme të cilat janë parakusht për lidhjen e Kontratës;

iii) nëse Parapaguesi brenda afatit prej 15 ditësh nga data e krijimit të ndryshimit të të dhënave të cilat janë parakusht për lidhjen e Kontratës nuk ia dërgon Mts-së të dhënat e reja.

Rrjeti dhe pajisja terminale

iv) nëse Parapaguesi e përdor pajisjen terminale e cila nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e vlefshme, ose me përdorimin e një pajisjeje të tillë terminale do të vinte deri te prishja e vazhdimësisë, sigurisë dhe/ose tërësisë së Rrjetit, ose nëse instalimi i shfrytëzuesit dhe pajisja kanë pësuar ndryshim;

v) nëse Parapaguesi pa autorizim hyn në rrjetin elektronik të komunikimit të Mts-së, e pengon funksionimin e rrjetit, ose bën çfarëdo ndërhyrjesh në Rrjet;

vi) nëse Parapaguesi ua beson personave të tretë riparimet ose mënjanimin e pengesave në pjesën e rrjetit i cili e mirëmban Mts;

vii) nëse Parapaguesi nuk ia mundëson qasjen Mts-së në ambientet ose në truallin në pronësi të tij ose ndaj të cilit ka të drejtë përdorimi, instalimin e vet, ose në pajisjen e vet, me qëllim të mënjanimit të pengesës në rrjetin të cilin e mirëmban Mts;

viii) nëse Parapaguesi nuk ia mundëson Mts-së kontrollin e instalimeve të veta, pajisjes terminale dhe pajisjes tjetër dhe softuerëve të domosdoshëm për shfrytëzimin e shërbimeve të Mts-së për të cilën dyshohet se e shkaktojnë pengesat teknike;

ix) nëse konstatohet parregullsia e pajisjes së Parapaguesit e cila e rrezikon Rrjetin ose Parapaguesit e tjerë në të, ose në rrjetin tjetër me të cilin është i lidhur rrjeti;

x) nëse rrjeti është i rrezikuar në mënyrë softuerike ose ekziston rreziku nga një rrezik i tillë, derisa të pushojë rreziku;

Shërbimet

xi) nëse konstatohet se Parapaguesi po i shqetëson Parapaguesit e tjerë të shërbimeve elektronike të komunikimit në Rrjet ose në rrjetat e tjera, po i ofendon, shqetëson, pengon dhe/ose pengon në përdorimin e shërbimeve;

xii) nëse konstatohet se Parapaguesi ua ka mundësuar personave jo të autorizuar përdorimin e shërbimeve të Mts-së përmes lidhjes së vet në Rrjet;

xiii) nëse konstatohet se Parapaguesi nuk po i respekton obligimet e tjera nga pika 9 e Kushteve të përgjithshme;

Pagimi i llogarisë

xiv) nëse Parapaguesi nuk e paguan llogarinë as pas 15 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë së dërguar nga ana e Mts-së për pagesë, me të cilin rast nga vërejtja gjithashtu kanë kaluar jo më pak se 8 ditë, por që, kur bëhet fjalë për shërbimet e thirrjeve, shërbimet ndërpriten pjesërisht, e jo në tërësi, domethënë kufizohen, ashtu që edhe më tutje e mundësohet trafiku i linjës thirrëse ardhëse dhe thirrjet e

shërbimeve për ndërhyrje urgjente xv) nëse Parapaguesi të cilit, për shkakun e theksuar në alinenë e mëparshme, shërbimet e linjës thirrëse i janë kufizuar, ashtu që trafiku i linjës thirrëse dhe thirrjet e shërbimeve për ndërhyrje urgjente kanë qenë të mundshme gjatë periudhës deri 45 ditë të ndërprerjes së pjesërishtme të përkohshme (kufizimit) të shërbimeve, obligimin e vet të pagesës nuk e kryen derisa të skadojë periudha e theksuar, në të cilin rast shërbimet i ndalen përkohësisht në tërësi me kusht që nëse ka kaluar afati prej jo më pak se 30 ditësh ose së paku një vërejtjeje xvi) nëse shfrytëzuesi nuk e ofron dëshminë e pagesës (depozitë e të ngjashme) në pajtim me pikën 7.6 të Kushteve të përgjithshme ose nuk e paguan avansin.

4. Ndërprerja e përkohshme e dhënies së një, disa ose të të gjitha shërbimeve të Mts-së, në rastin e keqpërdorimit zgjat 5 ditë, kurse për mospagimin e obligimeve në të holla deri në ditën e shlyerjes së obligimeve, por që Mts mundet përgjithmonë ta ndërprejë dhënien e shërbimit në pajtim me pikën 13 të Kushteve të përgjithshme.

Në rastet kur përmbajtja është e palejuar ose ndonjë keqpërdorim tjetër, në pajtim me ligjin është i autorizuar që ta konstatojë organi kompetent, masat e ndërprerjes së përkohshme mund t'i ndërmarrë vetëm pas përcaktimit të një keqpërdorimi të tillë nga ana e organit kompetent.

5. Gjatë kohës së shkyçjes së përkohshme nga Rrjeti përkatësisht ndërprerjes së dhënies së shërbimeve për të cilat shkak është faji i Parapaguesit, Parapaguesi ka për detyrë që të vazhdojë të paguajë kompensimin mujor për tërë periudhën sa është e vlefshme Kontrata për ndërprerjen e shërbimit. Shkaqet e theksuara për shkyçjen e përkohshme, përkatësisht ndërprerjen e dhënies së shërbimeve, aplikohen pa e marrë parasysh se a i ka shkaktuar Parapaguesi ose ndonjë person i tretë të cilit i është mundësuar që përmes shërbimit të cilin e ka kontraktuar Parapaguesi, dhe pavarësisht nga ajo a ka vepruar personi i tretë me dijeni ose pa dijeni të Parapaguesit. Parapaguesi ka për detyrë ta paguajë kompensimin sipas Çmimit në emër të shpenzimeve për aktivizimin e shërbimit të ndërprerë, i cili faturohet pasiqë ka pushuar shkakun për ndërprerjen e përkohshme të shërbimit dhe shërbimi përsëri riaktivizohet.

Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve me kërkesë të arapaguesit

6. Mts do t'ia mundësojë Parapaguesit, me kërkesën e tij, përkohësisht shkyçjen e lidhjes nga Rrjeti, përkatësisht ndërprerjen e përkohshme (ç'aktivizimin) e një, disa ose të gjitha shërbimeve të Mts-së, me përjashtim të shërbimit të qasjes në Internet dhe të shpërndarjes së përmbajtjeve të mediave, në kohëzgjatje prej 1 deri 3 muajsh. Shkyçja e përkohshme, përkatësisht ç'aktivizimi, mund të bëhet vetëm një herë brenda një viti. Gjatë kohës derisa lidhja përkohësisht është ç'aktivizuar, ose përkohësisht është ç'aktivizuar një ose më shumë shërbime, Parapaguesit i përlogaritet dhe i faturohet kompensimi mujor për ç'aktivizimin e përkohshëm të shërbimit. Shërbimet do të aktivizohen përsëri pas skadimit të afatit të dakorduar për ndërprerjen e përkohshme të dhënies së shërbimeve. Parapaguesi mund të kërkojë riaktivizimin e lidhjes përkohësisht të ndërprerë në rrjetin elektronik të komunikimit, përkatësisht ndërprerjes së përkohshme (ç'aktivizimit) të një, disa ose të gjitha shërbimeve edhe para skadimit të afatit të kontraktuar për ndërprerjen e përkohshme të dhënies së shërbimeve.

Çmontimi i përkohshëm i pajisjes së Mts-së ose pajisjes së Parapaguesit

7. Në rastin e punimeve investuese, pastrimit ose punimeve të tjera në ambient ose në pronën e Parapaguesit ku gjendet pajisja e Mts-së, ose pajisja e Parapaguesit të cilën e mirëmban Mts, Parapaguesi mund të kërkojë çmontimin e përkohshëm të pajisjes. Përveç kompensimit sipas Çmimit, Parapaguesi ka për detyrë t'ia paguajë Mts-së shpenzimet reale të çmontimit dhe të rimontimit të pajisjes.

Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve me qëllim të mbrojtjes së shfrytëzuesit

8. Mts përveç obligimeve të saj lidhur me kontrollin e shpenzimeve të përcaktuara me dispozitat e vlefshme e ruan të drejtën e kontrollit të konsumimit dhe përdorimit të shërbimeve të cilat ua ofron Mts shfrytëzuesve të vet, dhe këtë me qëllim të mbrojtjes së tyre.

9. Mts e ruan të drejtën që ta përcaktojë shumën e kontrollit ditor, javor dhe mujor të harxhimit, domethënë limitin ditor, javor dhe mujor, si edhe t'i konstatojë rastet në të cilat shfrytëzuesi bën tejkalime të të drejtave të veta në përdorimin e shërbimeve nga kontrata e lidhur. Mts në mënyrë adekuate (me thirrje telefonike ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme) e njofton shfrytëzuesin për tejkalimin e harxhimit, përkatësisht për tejkalimin e të drejtave në shfrytëzimin e shërbimeve, si edhe për obligimet të cilat lidhur me këtë rast vendosen për shfrytëzuesin. Nëse shfrytëzuesi i tejkalon shumat e theksuara të harxhimit, e që nuk e ka siguruar avansin e mjeteve për harxhimin e theksuar, do të realizohet ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimit në fjalë derisa t'i shlyen obligimet e krijuara.

Ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve për shkaqe teknike

10. Mts ka të drejtë që bashkë me njoftimin e mëparshëm të shfrytëzuesit, përkohësisht ta ç'aktivizojë lidhjen e Parapaguesit nga Rrjeti ose t'ia ndërprejë dhënien e një, disa ose të gjitha shërbimeve për këto shkaqe: i) nëse krijohen pengesat teknike në Rrjet, derisa ato të mënjanohen; ii) nëse Mts i zbaton punimet në rikonstruktim ose zgjerimin në rrjet në të cilin është i lidhur shfrytëzuesi.

12. Kohëzgjatja dhe pushimi i vlefshëmrisë së Kontratës

Kohëzgjatja

1. Kontrata me Parapaguesin nëse nuk është caktuar ndryshe lidhet për kohë të pacaktuar.

2. Ndërprerja/anulimi i kontratës dhe ndërprerja e dhënies së shërbimeve mund të bëhet sipas kërkesës së Parapaguesit ose sipas kërkesës së Mts-së për shkak të mosrespektimit të Kontratës ose të Kushteve të përgjithshme.

3. Parapaguesi ka për detyrë që t'i paguajë të gjitha obligimet e krijuara në emër të përdorimit të shërbimeve në periudhën para ndërprerjes së vlefshmërisë së Kontratës. Në rast se para skadimit të periudhës së kohëzgjatjes së obliguar të Kontratës, nëse Kontrata është lidhur me kohë të caktuar me periudhën minimale të kohëzgjatjes së

obliguar të Kontratës përkatësisht me periudhën minimale të vlefshmërisë së Kontratës Parapaguesi e anulon Kontratën ose Mts me fajin e Parapaguesit e anulon Kontratën, Parapaguesi ka për detyrë që njëherësh, deri në datën e afatit për pagimin e shumës së caktuar në llogari, Mts-së t'ia kompensojë dëmin në shumën e kompensimeve mujore për muajt e mbetur derisa të skadojë periudha e kohëzgjatjes së obliguar me Kontratë, sipas çmimit të vlershëm në ditën e anulimit përkatësisht ndërprerjes së Kontratës, dhe/ose t'ia kompensojë Mts-së dëmin në shumën tjetër nëse kjo është përcaktuar me Kontratë, në rastet kur kohëzgjatja e obliguar e Kontratës është zëvendësim për kompensimin e shpenzimeve të ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme në shumën e shpenzimeve të theksuara.

4. Në rastin e anulimit të Kontratës nga ana e Parapaguesit para instalimit/aktivizimit të bërë të shërbimit, Parapaguesi ka për detyrë t'ia kompensojë Mts-së të gjitha shpenzimet të cilat i ka pasur lidhur me instalimin/aktivizimin ose mënjanimin e pajisjes terminale, por jo më shumë se sa shuma e kompensimit për instalim, përkatësisht aktivizim sipas Çmimit të vlefshëm.

5. Kontrata do të pushojë të jetë e vlefshme nëse Mts e humb autorizimin e nevojshëm për dhënien e shërbimeve të kontraktuara në Rrjet.

Anulimi i kontratës me kërkesë të Parapaguesit

5. Parapaguesi mund ta anulojë Kontratën duke e njoftuar Mts-në me shkrim ose duke shkuar në zyre dhe duke e nënshkruar kërkesën për anulimin e Kontratës. Kërkesa për anulimin e kontratës dhe ndërprerjen e shërbimeve duhet t'i dërgohet Mts-së jo më pak se 30 ditë para datës së kërkuar që kur kërkohet që shërbimi të ndërpritet përgjithmonë.

6. Në ditën dhe në kohën kur Parapaguesi në kërkesë e shënon, Mts do ta ndërprejë dhënien e shërbimit ose shërbimeve për të cilat është bërë kërkesa.

7. Nëse anulohet vetëm ndonjë nga shërbimet, kushtet e kontraktuara të dhënies së shërbimeve të tjera, varësisht nga mundësitë teknike të Mts-së, do të vazhdojnë të aplikohen.

Anulimi i kontratës për shkak të shkeljes së obligimeve nga marrëdhënia kontraktuese nga ana e Parapaguesit

8. Mts ka të drejtë, në rastet kur Parapaguesi nuk i respekton obligimet nga Kontrata, që njëanshëm ta anulojë kontratën përkatësisht që përgjithmonë t'ia ndërprejë dhënien e një, disa ose të gjitha shërbimeve, duke e njoftuar më parë Parapaguesin. Në rastet kur përmbajtja e palejueshme ose ndonjë keqpërdorim tjetër në pajtim me ligjin është autorizuar ta konstatojë organi kompetent, masat e ndërprerjes së përhershme mund të ndërmerren pasiqë të përcaktohet një keqpërdorim i tillë nga ana e organit kompetent.

9. Mts nuk ka për detyrë të japë arsyetim dhe/ose ta kompensojë dëmin eventual i krijuar për shkak të ndërprerjes së përhershme të dhënies së shërbimeve, përveç nëse me Kontratë dhe me Kushte të përgjithshme nuk është përcaktuar më ndryshe.

10. Shkaqet për mënjanimin e Kontratës përkatësisht ndërprerjes së përhershme të dhënies së shërbimeve, janë kompetente pa e marrë parasysh kush i ka shkaktuar, Parapaguesi ose ndonjë person i tretë, me dijeni ose pa dijeni të Parapaguesit.

Pasojat juridike të ndërprerjes së vlefshmërisë së Kontratës midis Mts-së dhe Parapaguesit krijohen në ditën kur Mts e ka bërë ndërprerjen e përhershme, për çfarë Parapaguesi do të njoftohet në mënyrë adekuate.

Mts mundet njëanshëm ta anulojë Kontratën dhe përgjithmonë ta ndërprejë dhënien e shërbimit ose shërbimeve në këto raste:

Në përgjithësi

i) nëse adresa e Parapaguesit për dërgimin e llogarisë dhe njoftimi i Mts është i panjohur edhe pasi që përpiqet që t'ia dorëzojë për të dytën herë;

ii) nëse kundër Parapaguesit ka filluar procedura e falimentimit ose ndonjë procedurë e ngjashme, kurse për këtë janë krijuar kushtet sipas dispozitave në fuqi, me të cilin rast Mts do ta sigurojë minimumin e shërbimeve sipas kërkesës së drejtuesit falimentues;

Rrjeti dhe pajisja terminale

iii) nëse Parapaguesi, pasi që përsëri është lidhur në rrjetin pas ndërprerjes së përkohshme, përsëri e përdor pajisjen terminale për të cilën nuk e ka marrë lejen e mëparshme nga Mts;

iv) nëse Parapaguesi as pas përpjekjes së dytë brenda afatit prej 3 ditësh nuk ia mundëson Mts-së qasjen në pronë të vet ose në pronën të cilën ka të drejtë ta përdorë, në instalim të vet, pajisjes së vet me qëllim të mënjimit të pengesës në rrjet;

v) nëse Parapaguesi as pas 15 ditësh nga përpjekja e parë nuk ia mundëson Mts-së kontrollin e instalimeve të veta, pajisjes terminale dhe pajisjes tjetër dhe softuerëve të domosdoshëm për përdorim të shërbimeve të Mts-së në pajtim me Kushtet e përgjithshme;

Shërbimet

vi) në të gjitha rastet në të cilat nuk është respektuar afati ose aktiviteti për shkak të të cilave është krijuar ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve, pas skadimit të afatit të dhënë;

vii) në rastin e shkeljes më të rëndë ose të përsëritur të obligimit të Parapaguesit për shkak të të cilës është krijuar ndërprerja e përkohshme e dhënies së shërbimeve.

Pagimi i llogarisë

viii) nëse Parapaguesi nuk i shlyen borxhet e veta të maturuara as pas 75 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë së dërguar nga ana e Mts-së për pagesë, nën kushtet se ka kaluar afati prej jo më pak se 30 ditësh nga dita prej së paku një vërejtjeje dhe jo më pak se 8 ditësh nga vërejtja para ndërprerjes së përhershme të dhënies së këtij shërbimi ose shërbimeve;

ix) nëse pas 75 ditësh nga dita e maturimit të llogarisë për pagesë Parapaguesi edhe më tutje është jo i aftë për pagesë, përkatësisht është tepër i ngarkuar, kurse procedura e falimentimit nuk ka filluar.

13. Kalimi i të drejtave të Kontratës dhe pasardhësia juridike

1. Parapaguesi mund t'i përcjellë të drejtat dhe obligimet nga Kontrata në person të tretë, me kusht që Parapaguesi i ri të vazhdojë t'i përdorë shërbimet në të njëjtën vendndodhje, përmes lidhjeve të njëjta në rrjetin elektronik të komunikimit, bashkë me kompensimin e përcaktuar me Listë të çmimeve, me të cilin rast me Parapaguesin i cili i ka bartur të drejtat dhe obligimet e vlefshmërisë së Kontratës pushon, kurse me Parapaguesin e ri lidhet Kontratë e re.

2. Në rast të shërbimeve të tjera, përveç atyre të theksuara në pikën 15.1, kalimi i të drejtave të kontratës dhe bartja e cilësdo të drejte dhe obligimi nga kontrata janë të mundshme bashkë me pëlqimin e mëparshëm me shkrim Mts-së.

3. Në rast se vdes Parapaguesi, bartjen e të drejtave dhe obligimeve nga Kontrata mund ta kërkojnë pasardhësit, anëtarët e familjes, ose, nëse janë më shumë, personi të cilin e caktojnë pasardhësit ose anëtarët e familjes.

14. Informatat dhe përkrahja shfrytëzuesve

1. Shfrytëzuesi e pranon që Mts ka të drejtë që drejtpërsëdrejti t'i dërgojë njoftimet, përmes postës elektronike përkatësisht përmes kanaleve të tjera të komunikimit, për ofertat e shërbimit të Mts-së si edhe shërbimet të cilat i ka zhvilluar Mts me partnerët e vet kështu që këto shërbime i ofron bashkarisht me partnerin ose e siguron përkrahjen e dhënies së shërbimeve partnerëve përmes rrjetit. Mund të ndalohet dërgimi i mesazheve të theksuara përmes postës elektronike, duke e thirrur Qendrën për kontakte ose drejtpërsëdrejti në zyre të Mts-së.

2. Mts në faqen e vet të internetit, përmes postës elektronike dhe kanaleve të tjera të komunikimit do ta kryejë informimin e parapaguesit /shfrytëzuesit për çështjet e rëndësishme lidhur me dhënien e shërbimeve, siç janë: shuma e llogarisë, paralajmërimet për limite, informatat për ndryshimet e Kushteve të përgjithshme, si edhe kushtit të dhënies së disa shërbimeve dhe etj., e të cilat nuk mund të karakterizohen si shpallje e drejtpërdrejtë e shërbimeve nga paragrafi 1 i kësaj pike.

3. Njoftimet lidhur me ofertën e Mts-së, me Listat e çmimeve të shërbimeve dhe me mënyrën e përdorimit të tyre, shfrytëzuesit mund t'i marrin në faqen zyrtare të internetit të Mts www.mtsdoo.com, duke e thirrur numrin e Qendrës për kontakte 19933, përmes adresës së emailit: info@mtsdoonet, në zyra dhe në vende të tjera të shitjes së Mts-së. Përkrahjen lidhur me përdorimin e shërbimeve shfrytëzuesit mund ta kërkojnë përmes numrave të njëjtë përkatësisht faqes së njëjtë të Internetit të Mts-së.

4. Informatat për parametrat e cilësisë së shërbimeve shfrytëzuesit mund t'i marrin në zyra dhe në vende të tjera të shitjes si edhe në faqen zyrtare në Internet të Mts-së www.mtsdoo.com.

5. Përveç në rastet kur me dispozitat e tjera të Kushteve të përgjithshme ose dispozitave të Kontratës është përcaktuar ndryshe, shfrytëzuesit/parapaguesit mund t'ia dërgojnë Mts-së të gjitha njoftimet dhe kërkesat lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikimin e Kontratës duke përfshirë paraqitjen e mesazheve jo të kërkuara, me dërgimin në adresën ose duke i thirrur numrat e theksuar në paragrafin tre të kësaj pike, ose përmes tyre të marrin njoftime për mënyrën sipas së cilës dërgohen disa lloje të kërkesave.

15. Rregullat për kompensimin e dëmit Parapaguesit

1. Parapaguesi e paraqet në formën me shkrim kërkesën për kompensimin e dëmit në rastin e mosplotësimit të obligimit ose vonimin në plotësimin e obligimit nga ana e Mts-së në adresën e shënuar në llogari. Kërkesën për kompensimin e dëmit Parapaguesi e paraqet brenda afatit prej 2 muajsh nga dita e krijimit të dëmit.

2. Dëmi do të paguhet me zvogëlimin e borxhit Parapaguesit në llogari për çdo muaj gjithnjë derisa do të paguhet tërë shuma e dëmit. Dëmi mund të paguhet edhe në ndonjë mënyrë tjetër nëse këtë e kërkon Parapaguesi, kurse Mts pajtohet, ose në ndonjë mënyrë tjetër që është urdhëruar me gjyq.

3. Parapaguesi nuk ka të drejtë për kompensim të dëmit:

i) nëse është ndokush tjetër, e jo Mts shkaktar i dëmit;

ii) në rastet e tjera në të cilat Mts është liruar nga përgjegjësia sipas të gjitha dispozitave të Kushteve të përgjithshme.

4. Nëse Mts nuk i respekton afatet e kontraktuara për ofrimin e shërimit, duke i përfshirë afatet veçanërisht të harmonizuara me Parapaguesin, Parapaguesi ka të drejtë për kompensim në shumën prej 50% të shumës së shpenzimeve të sigurimit të qasjes në Rrjet (taksat hyrëse).

Nëse Mts nuk i respekton afatet për mënjanimin e pengesave dhe ndryshimet e numrit të telefonit, Parapaguesi ka të drejtë për kompensim në shumën prej 10% të kompensimit mujor për çdo ditë pune të tejkalimit, por jo më shumë se 2 kompensime mujore. Mts nuk ka për detyrë ta bëjë kompensimin e dëmit në rast se shkaqet për tejkalimin e afateve janë fuqia madhore ose ngjarjet për të cilat Mts nuk mban përgjegjësi (për shembull, pranimi i kushteve dhe lejes për ndërtim, sigurimi i kushteve dhe i pajisjes nga ana e Parapaguesit e të ngjashme).

5. Mts mban përgjegjësi për nënkontraktuesit e vet

6. Në rast se Parapaguesi e ka pësuar dëmin më të madh se sa shuma e kompensimeve të përkufizuara me Kushtet e përgjithshme, ka të drejtë të kërkojë dallimin derisa të kompensohet plotësisht dëmi i vërtetë dhe i drejtpërdrejtë që duhet të dëshmohet. Ngarkesa e dëshmimit të një dëmi të tillë i mbetet Parapaguesit.

7. Mts, në kufijtë e lejuar me ligj, nuk mban përgjegjësi për humbje indirekte, përfitimin e humbur, ose humbjen e të dhënave, as nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar me çfarëdo shfrytëzimi joligjor të shërbimeve ose me shkeljen e obligimeve

kontraktuese nga ana e Parapaguesit ose nga personat e tretë me të cilat kjo është mundësuar me përdorimin e shërbimeve nga ana e Parapaguesit.

16. Zgjidhja e kontesteve

1. të gjitha kontestet e krijuara lidhur me përdorimin e Shërbimeve do të zgjidhen me marrëveshje. Kontestet të cilat nuk mund të zgjidhen me marrëveshje, do t'i zgjidhë gjykata kompetente.

17. Dispozitat përfundimtare

1. Këto Kushte të përgjithshme, hyn në fuqi dhe aplikohen në ditën e publikimit të të njëjtave.

2. Ditën e hyrjes në fuqi dhe me fillimin e aplikimit të Kushteve të përgjithshme, pushojnë të jenë të vlefshme Kushtet e përgjithshme për dhënien e shërbimeve në rrjetin publik fiks të rrjetit të Telekomit Serbia, të publikuara më 09.12.2015.